



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokumet parlamentar

Tiranë më 12 Maj 2014

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN
NR.9741, DATË 21.5.2007, “PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ***në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi***, në mbledhjen e datës 5 Maj 2015 mori në shqyrtim projektligjin ***“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9741, dt. 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.***

Komisioni i Ligjeve, për shqyrtimin e këtij projektligji, caktoi relatore deputeten Vasilika Hysi. Në mbledhjen e Komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm, znj. Milva Ikonimi, zëvendës Ministre e Shëndetësisë dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Z.Erzen Tola, Drejtor i Shërbimeve Juridike dhe znj. Linda Pustina, Drejtore e Arsimit të Lartë dhe Shkencës .

Komisioni i Ligjeve e shqyrtoi këtë projektligj në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

1. Analiza e projektligjit nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore

Ky projektligj vjen me nismë të Këshillit të Ministrave dhe është hartuar me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të Ministrit të Shëndetësisë. Analiza e nismës ligjore

tregon se projektligji është bazuar në nenin 78¹, 81 pika 1 dhe 83 pika 1² të Kushtetutës. Nga analiza e projektligjit rezulton se fusha që rregullon ai nuk përfshihet në asnjë prej çështjeve që trajton nga neni 83, pika 2 e Kushtetutës, për rrjedhojë miratimi i projektligjit i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm përsa i përket shumicës.

2. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji synon të përmirësojë raportet ndërmjet institucionit të arsimit të lartë dhe Qendrës Spitalore Universitare (QSU), si pjesë përbërëse e tij, duke krijuar kushtet për një mirëfunksionim të shërbimit spitalor që ofrohet nga QSU-ja. Gjithashtu, ndryshimet e propozuara synojnë të ofrojnë një shërbim spitalor cilësor për popullatën dhe të garantojnë mësimdhënie dhe kërkim shkencor bashkëkohore.

Sipas relacionit që shoqëron projektligjin vërhet se, ndryshimet që pësoi në vitin 2010, Ligji nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, prekën dhe aspekte të organizimit të shërbimeve spitalore. Gjatë zbatimit në praktikë të ligjit të ndryshuar, u vërejtën problematika në organizim, sa i takon anës mësimore, por dhe ofrimit të shërbimit shëndetësor. Kjo u shoqërua me probleme edhe në marrëdhëniet ndërmjet njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë.

3. Risitë bazë të projektligjit

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në projekt-ligj përfshihen në 7 nene, dhe përmbledhen si më poshtë vijon:

- Rifutet koncepti i departamentit si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ky rregullim mundëson forcimin punës mësimore dhe kërkimore në qendrën spitalore universitare, përmirëson mbarëvajtjen e shërbimeve të ndryshme spitalore që grupohen brenda një departamenti.
- Shërbimet konsiderohen si njësi në varësi të departamentit të cilat kryejnë dy llojë aktivitete: **së pari** aktivitete mesimor e kërkimor, si pjesë e institucionit të arsimit të

¹ Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar

² Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.

lartë dhe së dyti, aktivitet diagnostikues dhe trajtues themelor, si pjesë e spitalit universitar.

- Mënyra e funksionimit të shërbimeve dhe kriteret e përzgjedhjes së përgjegjës të shërbimeve do të jenë objekt i rregullimit të akteve nënligjore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e shëndetësisë.
- Ndryshon organi që miraton statutin që rregullon veprimtarinë e qendrës spitalore, e drejtë që i kalon Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe sportit dhe Ministrit të Shëndetësisë.
- Ndryshon numri i anëtarëve, përbërjes së Bordit të Qendrave spitalore universitare të institucioneve të arsimit të lartë publik dhe ka disa ndryshime në kompetenca. Konkretisht:
 - a) Numri i personave në bord rritet nga 5 në 7 persona, përfshirë edhe drejtuesin e tij
 - b) Shtohen dy përfaqësues, përkatësisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave.
 - c) Përfaqësimi në bord zgjerohet me përfaqësues nga radhët e shoqatave të bashkive, Kryqit të Kuq Shqiptar dhe shoqatave të pacientëve;
 - d) Mënyra e përfaqësimit të përfaqësuesve të shoqatave dhe Kryqi i Kuq përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - e) Nuk përfshihen në radhët e bordit, rektori i institucionit të arsimit të lartë; Kryetari i Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor (ISKSH).
- Vendoset përgjegjësi i njësisë kërkimore-mësimore/përgjegjësi i shërbimit në radhët e autoritetit drejtues të një institucioni publik të arsimit të lartë.
- Ligji parashikon që në institucionin e ri publik të Arsimit të Lartë rektori cakton dekanin dhe Dekanin/drejtorin e emëruar cakton përgjegjësin e departamentit/qendrës së kërkimit dhe zhvillimit. Propozohet që në vend të caktimit të këtë përzgjedhje sipas kriterëve të bëra publike.
- Emërtimi i institucioneve përgjegjëse në ligj përshtatet me ndryshimet që ka pësuar emërtimi i Ministrisë së që mbulon çështjet e arsimit të lartë

4. Çështje të diskutuara

Me qëllim bashkërendimin e mbikqyrjes së Qendrës Spitalore Universitare (QSU) si qendër arsimore-kërkimore dhe shëndetësore, bazuar në orientimet e dhëna në dy konferencat e fundit të Ministrave të Arsimit në Europë³ sa i takon përfaqësimit në strukturat e Arsimit të Lartë si dhe duke patur parasysh parimet që udhëheqin deklaratën e Bolonjës⁴, relatorja e projektligjit nënvizoi se do të ishte me interes të diskutohej përbërja e Bordit të QSU (si e vetmja qendër terciare në Shqipëri). Duke qenë se përbërja dhe kompetencat e bordit janë më shumë në drejtim të administrimit të qendrës spitalore universitare në funksion të diagnostikimit dhe trajtimeve sesa të arsimit dhe kërkimit, relatorja nënvizoi faktin se do ishte me interes që të harmonizoheshin të dy aspektet e veprimtarisë së QSU si qendër që ofron funksione diagnostikuese dhe trajtuese dhe qendër arsimore dhe kërkimore në të njëjtën kohë. Gjithashtu relatorja sugjeroi përfshirjen në projektligji të një dispozite për parashikimin e afateve të nxjerrjes së akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave dhe akteve të tjera.

Disa prej çështjeve të diskutuara nga anëtarët e Komisionit, përfaqësues të mazhorancës dhe opozitësi ishin:

- a) U kundërshtua përfaqësimi në radhët e anëtarëve të Bordit të QSU-së nga përfaqësues të shoqatave të bashkive, Kryqit të Kuq Shqiptar dhe shoqatave të pacientëve;
- b) U kundërshtuan propozimet për vendosjen e kriterëve të përzgjedhjes së përgjegjësit të shërbimeve me vendim të Këshillit të Ministrave dhe jo në ligj;
- c) U sugjerua që ndryshimet e propozuara të rishikohen së bashku me ndryshimet që janë duke u bërë në kuadër të një nisme tjetër që është duke u ndërmarrë në ligjin për arsimin e lartë sepse ndërhyrjet e shpeshta në ligj shkaktojnë konfuzion;
- d) U vlerësua se me ndryshimet e propozuara, mekanizmi i shërbimeve spitalore do të vendoset nën kontroll dhe do dobësohej decentralizimi;

Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhanë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit si vijon:

³ Të zhvilluara në Leuven/Louvain-la-Neuve, në Belgjikë (në dt. 28-29 Prill 2009) dhe në Bukuresht të Rumanisë (në dt. 26 dhe 27 Prill 2012) http://www.aqu.cat/aqu/marc_legal/ees_en.html#_U2TaD4GSyzE - Ministrat Evropianë deklaruan se do të mbështesin angazhimin dhe pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit akademik në strukturat drejtuese të të gjitha niveleve si dhe përsëritën zotimin e tyre për institucione të arsimit të lartë, autonome dhe të përgjegjshme, të cilat përqasin lirinë akademike.

⁴ Deklaratën e përbashkët të Ministrave të Arsimit të Evropës, të dt. 19 Qershor 1999

- Me ndryshimet e propozuara në përbërjen e bordit të QSU synohet që kjo qendër të përmirësojë së pari shërbimin spitalor, dhe me anë të tij të mundësojë ofrimin e mësimdhënies;
- Propozimi për përfaqësim në bord nga Shoqata e bashkive është bërë duke patur në konsideratë sistemin e referimit të shërbimit mjekësor nga niveli lokal në atë qendror ndërkohë që përfaqësimi nga Kryqi i Kuq dhe Shoqata e pacienteve merr shkas nga bashkëpunimi dhe fakti i të qenurit grup interesi;
- Duke qenë në prag të fillimit të vitit akademik vlerësohej e nevojshme për sistemin e QSU-së të riorganizohen shërbimet;
- Ekziston domosdoshmëria e ndarjes së shërbimeve në QSUT dhe rritja e besimit në klasën e profesoratit sa i takon përzgjedhjeve që do bëhen sipas ndryshimeve të propozuara;

5. Propozimet për ndryshime

Gjatë shqyrtimit nen për nen, u propozuan dhe u miratuan me shumicën e anëtarëve të pranishëm të Komisionit të Ligjeve, ndryshimet e mëposhtme:

- ***Neni 1 sugjerohet të ndryshohet si vijon:***

“Kudo në ligj emërtimet “Ministria e Arsimit dhe Shkencës” dhe “Ministri i Arsimit dhe Shkencës” zëvendësohen përkatësisht me “Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit” dhe “Ministri përgjegjës për çështjet e arsimit”.

- ***Hiqet pika 2, e ndryshimit të propozuar në nenin 12/1⁵ sepse përmban të njëjtin formulim me ligjin ekzistues***

- ***Pas nenit 6 sugjerohet të shtohet neni 7 me përmbajtje si vijon:***

Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për çështjet e Arsimit dhe Ministrit të Shëndetësisë, nxjerr aktet nënligjore për vënien në zbatim të këtij ligji.

PËRFUNDIM

⁵ Neni 3 I projektligjit

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut shqyrtoi nen për nen dhe miratoi me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij të gjitha propozimet e paraqitura nga relatori i projektligjit dhe anëtarët e Komisionit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i sugjeron Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik që të marrë në shqyrtim dhe të miratojë ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në Komisionin e Ligjeve, për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9741, dt. 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Së fundmi, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi e shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9741, dt. 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, në parim, nen për nen dhe në tërësi, me unanimitet e miratoi atë, duke vlerësuar se:

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin e teknikës legjislative, përveç ndryshimeve të miratuara gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit, Komisioni i Ligjeve nuk ka vërejtje dhe riformulime të tjera.

RELATORJA

Vasilika Hysi

KRYETARI

Fatmir Xhafaj